



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:030918  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05636983

KPPP.nr.2005/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Avokat Leutrim Ademi me numër të biznesit 810186785 me seli në Mitrovicë, kundër debitorit Prokuroria Themelore e Mitrovicës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.03/2022 të datës 01.02.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj me seli në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 29.04.2024, merr këtë

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Prokuroria Themelore e Mitrovicës ashtu që ANULOHET Urdhri përmbartimor P.nr.03/2022 të datës 01.02.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Avokat Leutrim Ademi, me datë 01.02.202, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.03/2022 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit: faturë nr. P-07/2020 e datës 31.08.2020 duke urdhëruar debitorin që kreditorit t'ia paguajë shumën prej 500.00 EUR ( pesëqind euro), si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit për lejimin e duke theksuar se kreditori ka mbrojtur në 6 raste një të mitur e jo disa, për të gjitha këto raste ka kërkuar të paguhet në lartë prej 68.00 euro, e që në fakte ashtu siç është udhëzuar një kompasin i tillë nuk i takon se vetëm për fillimin e procedurës lartësia është prej 88.00 euro e pastaj për sa kohë qëndron në këto raste me që është fjala për një klient llogaritet për qindja për orë shtesë dhe lidhur me këtë kreditori ju ka drejtuar debitorit me faturë fillestare në vlerë prej 528.00 euro e

cila faturë për shkak të plotësimit të gabuar i është kthyer mbrapa kreditorit me këshillë që ta plotësoj siç parashohin rregullat mbi pagesën e avokatëve sipas detyrës zyrtare. Meqenëse i njëjti nuk është pajtuar atëherë faturën e ka dorëzuar me postë e lidhur me këtë zyrtari i postës ka përpiluar shënim zyrtar A.nr. 147/20 të datës 10.08.2020, ndërsa fatura e pranuar me postë është kthyer përmes postës rekomande. Ndërkohë kreditori sërish ka dorëzuar tek debitori faturën e njëjti në bazë të së cilës përmbaruesi privat ka lëshuar urdhrin e kontestuar në këtë procedurë, pasi që debitori edhe këtë faturë e ka thyer mbrapa me datën 17.09.2021 duke e njoftuar se ja kthen faturën dhe formularin e nënshkruar nga ana e prokurorisë së rastit në shumë prej 108.00 euro si dhe formularin tjetër të cilit ja ka bashkëngjitur faturën në lartësi prej 528.00 euro. Pas tjerash ka theksuar se sipas nenit 29 të LPP-së dokument i besueshëm është fatura, por për të qenë dokument përmbarues fatura duhet të jetë e dorëzuar debitorit dhe të mos jetë kontestuar fare nga ana e debitorit, e që në rastin konkretë kjo faturë është kontestuar nga ana e debitorit dhe nga vetë ky fakte nuk mund të shërbej si dokument përmbarimor, në fund i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit fatura është lëshuar dhe plotësuar për secilën lëndë dhe për secilin veprim, dhe fatura është bërë sipas udhëzimit përkatës dhe praktikës, pos tjerash ka shtuar se debitori nuk ka pasur të drejtë ta kundërshtoj faturën sepse fatura është bërë konform lëndëve të përfaqësuara me orë dhe veprime të ndryshme, e tërë procedura është zhvilluar konformë kërkesës së prokurorisë dhe lejes së OAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti – Fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbnim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret fatura është dorëzuar përmes postës, ndërsa debitori në përmes parashtresës së datës 16.09.2021 e cila e përmban e ka kundërshtuar faturën dhe dhe formularin e nënshkruar ndërsa kreditorin e ka udhëzuar që për çdo pakjartësi ti drejtohet prokurorit.

Meqenëse debitori e ka kundërshtuar faturën, gjykata vlerëson se nuk është bërë dorëzim i rregullt i faturës dhe e njëjta nuk mund të shërbejë si dokument përmbnimor në këtë çështje përmbnimore.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbnimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2005/22, datë 29.04.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.